



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 796/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me apelin e Arlinda Morina, anëtare për Kuvendin Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Arlinda Morina, anëtare për Kuvendin Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, me shenjën ZL.Anr.796/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.796/2017 me datën 09.11.2017, nga Arlinda Morina, anëtare për Kuvendin Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik PDK, në të cilën pretendon se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave në këto Vendvotime: 1009D/01, 02, 03, 04D dhe 1009D/01R, në shkollën “Ivail Qemaili” 1001d/01r, 100d/02r, 1001d/03r, 1001d/04r, 1001d/05r dhe 1001d/06d, në shkollën e mesme teknike 1001x/01r, 100x/02r, 1001x/03r, 1001x/04r dhe 1001x/05d, në shkollën fillore “Abdullah Presheva” 1024d/01r, 1024d/02r, 1024d/03r, 1024d/04d, në fshatin Kopernicë 1029d/01r, 1029d/02d, në Topanicë 1002d/01r, 1002d/02r, 1002d/03d. Më tej parashtruesja e ankesës ka cekur emrat e disa dëshmitarëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apelit gjeti se parashtruesin i apelit me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar për ti vërtetuar pretendimet e saj. Prandaj Paneli apelin e parashtrueses së apelit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe

si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.796/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuese e Panelit

Rafet Haxhaj



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*